



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT/ / OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RODNU RAVNOPRAVNOST/

Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ), raporti i aktiviteteve të realizuara gjatë periudhës Janar- dhjetor 2024

Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) është agjenci ekzekutive në kuadër të Zyrës së Kryeministrit është organ më i lartë i politikë bërjes, monitorimit dhe raportimit që ka të bëjë me zbatimin e Ligjit për Barazinë Gjinore, fuqizimit të rolit të grave dhe vajzave, dhe agjendën e barazisë gjinore të Kosovës në përgjithësi. Prioritetet afatgjata dhe afatshkurtra të agjendës së punës së Agjencisë janë vendosur në kuadër të zbatimit të LBGJ dhe kornizës ligjore që në tërësi garanton barazinë gjinore si pjesë e pa ndashme e drejtave të njeriut.

Në zbatim të Ligjit për Barazi Gjinore- Nenit 11, Qeveria e Republikës së Kosovës ka hartuar dhe miratuar Programin e Kosovës për Barazi Gjinore -PKBGJ 2020 -2024, me vendimin Nr.01/34, nën udhëheqjen e Agjencisë për Barazi Gjinore – Zyra e Kryeministrit.

Zbatimi i Prioriteteve të Planit të veprimit të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore (PKBGJ) 2020-2024

I. Në zbatim të Nenit 6 të LBGJ- ABGJ ka propozuar vazhdimin e Masa afirmative për regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve pa pagesë(“Udhëzimi administrativ për regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve pa pagesë) UA është vazhduar edhe për një vit prill 2023-prill 2024. Nga kjo masë afirmative për periudhën janar- dhjetor 2023 janë regjistruar 5050 prona ne emër te dy bashkëshorteve, ndërsa nen total janë 17 592 çifte që kanë pronën ne emër te përbashkët.

ABGJ Subvencionimi i 3 OJQ-ve Është ofruar mbështetje përmes subvencionimit të OJQ -ve e cilat punojnë në fushën e barazisë gjinore dhe parandalimit të dhunës ndaj grave me fokus te kategoritë me nevoja të veçanta, gratë nga minoritetet etnike Roma, Ashkali dhe Egjiptian, nënave vetushqyese dhe moshat e treta me vlerën **40.000 euro**. :

- ✓ Shoqatën e të verbërve të Kosovës me projektin “ **Vetëdijesimi i vajzave dhe grave te verbëta për shëndetin dhe kancerin e gjirit**” .
- ✓ General Youth Education of Kosovo GYEK- me projektin “ **Aftësimi i vajzave dhe grave të komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian për tregun e punës**”.
- ✓ OFAP- me projektin “**Ngritja e kapaciteteve të nënave vetushqyese për disiplinimi pozitive në prinderimin e përditshëm**”

- ✓ Komitetin e grave të verbëta të Kosovës me projektin” *Zhvillimi i aftësimeve për qasje në treg të punës të gratë dhe vajzat e verbra në Kosovë.*

ABGJ me synim të përmirësimit të situatës së grave nga kategoritë specifike ka zbatuar **masën e ndërmarrë nga Qeveria e RKS Vendimi nr. 04/197.** Masa 1.7 Skema e Granteve për Zanate të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, duke mbështetur **64 familjare- gra dhe vajza** të familjeve përfituese të pensioneve për familjare të zhdukur gjatë luftës në Kosovë, me shumën **249,460.00** euro në realizimin e blerjes së pajisjeve për punë sipas specifikave në thirrje-kryesisht pajisje bujqësore.

II. Ne zbatim të Nenit 5 të Ligjit për Barazi Gjinore –Masat e përgjithshme për parandalimin e diskriminimit gjinor dhe sigurimin e barazisë gjinore, ABGJ ka punuar në drejtim të :

- ✓ ABGJ ka mbështetur themelimin e Rrjetit të Grave në administratë publike në bashkëpunim me Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar. Mbështetja ka vazhduar me 4 punëtorë, me qëllim të fuqizimit të rolit të grave në administratë publike dhe inkurajimit për të aplikuar për pozita vendimmarrëse, shkëmbimit të përvojave dhe ndarjes së sfidave. Morën pjesë 121 pjesëmarrëse.
- ✓ ABGJ dhe Ministria e Financave Punës dhe Transfereve kanë themeluar grupin punues për hartimin e kornizës ligjore për Buxhetimin e përgjegjshëm gjinor; është hartuar metodologjia e punës dhe paketa informuese për GP. Grupi punues institucional për hartimin e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor ka realizuar 3 punëtorë (7 dite). Grupi Punues është duke u mbështetur me asistencë teknike nga UN WOMEN përmes Programit Rajonal të Ballkanit Perëndimor, financuar nga SIDA.
- ✓ Ne zbatim të aktiviteteve të dalura nga koncepti i dokumentit të Buxhetimit të përgjegjshëm gjinor dhe në zbatimin e objektivit të zhvillimit të qëndrueshëm 5C1, ABGJ dhe Ministria e Financave Punës dhe Transfereve në mbështetje të UN Women kanë organizuar punëtorë dy ditore. Në këtë punëtori morën pjesë Deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe stafi i Kuvendit të Kosovës.
- ✓ ABGJ në bashkëpunim me Zyrtaren për Barazi Gjinore në komunën e Fushe Kosovë ka organizuar punëtorinë për Buxhetimin Gjinor. Në këtë punëtori ishin prezent zyrtarë nga Komuna e Fushë Kosovës të cilët u njoftuan për rëndësinë e BPGJ, për integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha fazat e proceseve buxhetore.
- ✓ ABGJ, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve dhe UN women ka bashkë organizuar takim për 25 zyrtarë të nivelit vendimmarrës nga institucionet publike. Ky takim do të përshkruajë alokimin buxhetor dhe shpenzimet publike që synojnë promovimin e barazisë gjinore.
- ✓ ABGJ, Ministria e Financave Punës dhe Transferova dhe Ministria e Pushtetit Lokal me mbështetjen e UN women ka bashkë organizuar punëtori dyditore për 40 zyrtarë të 16 Komunave si ZBGJ, drejtoret e financave mbi çështjet e integritetit të buxhetimit të përgjigjeshëm gjinor në qarkoret buxhetore.

III. Në zbatim të LBGJ Nenit 11 , Programi i Kosovës për Barazi Gjinore - PKBGJ, ABGJ ka ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

Gjatë viti ABGJ ka realizuar raportin e dytë vlerësues për zbatimin e PKBGJ për periudhën raportuese 2022, buxheti total 1001 euro, ndërsa është hartuar dhe prezantuar edhe vlerësimi final i Programit të Kosovës për Barazi Gjinore (PKBGJ) për periudhën 2020-2024.

- ✓ Raporti monitorues për vlerësimin e PKBGJ për vitin 2022 <https://abgi.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/ABGJ%20Monitorimi%20i%20PKBGJ%20ne%203%20gjuhet%20final%20per%20web.pdf>
- ✓ ABGJ ka iniciuar hartimin e PKBGJ 2025-2035, dhe planit të veprimit të tretin me radhë. Është themeluar grupi punues me Vendim të Qeverisë, është hartuar dhe prezantuar metodologjia për hartimin e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2025-2035. Përmes këtij programi, Agjencia synon të hartoj një politikë publike e cila mundëson fuqizimin e rolit dhe përfshirjen e grave dhe burrave në të gjitha fushat e jetës sociale, ekonomike dhe politike, duke siguruar një qasje të barabartë për të gjithë.

IV. Ngritja e Kapaciteteve – ABGJ në zbatim të Prioriteteve të vendosura në PKBGJ Strategjinë për Mbrojtje nga Dhuna në familje dhe dhuna ndaj Grave 2022-2026, dhe në zbatim të drejtpërdrejtë të Konventës së Stambollit , ka ndërmarrë këto veprime:

- ✓ Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Policinë e Kosovës ka mbajtur 5 sesione informues lidhur me Konventën e Stambollit dhe ndryshimet në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore me mbikëqyrësit rajonal të hetimeve të dhunës në familje në kuadër të stacioneve policore të drejtorisë rajonale në këto komuna: ***Prishtinë, Peje, Gjiilan, Prizren dhe Ferizajt*** në këto sesione trajnuese morën pjesë ***106 persona në total prej tyre 82 burra dhe 24 gra.***
- ✓ Në zbatim të obligimit të dalë nga Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 08/L-185 – ABGJ ka themeluar grupin punës punës për plotësimin dhe ndryshimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore. Grupi i punës ka mbajtur punëtori 6 ditore, procesi në vazhdimësi.

V. Në zbatim të Nenit 21 të LBGJ, ABGJ ka ndërmarrë këto aktivitetet gjatë vitit 2024

- ✓ Agjencinë për Barazi Gjinore/ZKM në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës/ Fakulteti Ekonomik dhe me mbështetje të Un Women ka mbajtur ***Konferencën” Mbyllja e hendekut gjinor”***. Konferenca ka sjellë bashku studiues/e, politikëbërës/e, aktivistë/e, dhe individë të pasionuar pas barazisë gjinore për t'u angazhuar në dialog, për të ndarë njohuri dhe për të

diskutuar praktikat e mira ndërkombëtare dhe vendore për krijimin e një bote më gjithëpërfshirëse dhe të barabartë.

- ✓ ABGJ së bashku me profesor dhe studentë të Fakultetit Ekonomik kanë mbajtur një tryezë diskutimi për librin i cili është përkthyer në gjuhë shqipe nga një numër i profesorëve me titull **'Hyrje e Avancuar në Ekonomiksin Feminist'**, autores Joyce P. Jacobsen. Libri përbën një kontribut të shkëlqyer në informimin e argumentuar dhe shkencor të debatit në shoqëri për rëndësinë e barazisë gjinore, si për individin dhe familjen, ashtu edhe për shoqërinë. Me këtë rast ABGJ ka dhuruar për Bibliotekën e Fakultetit Ekonomik **120 kopje të librit "Hyrje e Avancuar në Ekonomiksin Feminist"**, i autores Joyce P. Jacobsen, i përkthyer në gjuhë shqipe.
- ✓ ABGJ së bashku me NDI- ka mbajtur shkollën verore mbi Gjinin Ekonominë dhe Politikën. Ku në programin 5 ditor ka bashkuar 28 student dhe lider të rinj në një mjedis multietnik nga moshë 18 - 29 vjeçar.

VI. Ngritja e Kapaciteteve të stafit të ABGJ si dhe të Zyrtareve për Barazi Gjinore në nivel komunal dhe ministrior –

- ✓ Zyrtarë të ABGJ-së për dy ditë radhazi kanë mbajtur trajnimin lidhur me kornizën ligjore për parandalimin e korrupsionit, identifikimin dhe menaxhimin e konfliktit të interesit, mbrojtja e sinjalizuesve dhe mekanizmat e raportimit, masat parandaluese për konfliktin e interesit dhe mbështetja e konfliktit, deklarimi i pasurisë dhe menaxhimi i dhuratave etj.
- ✓ ABGJ në zbatim të planit të integritetit ka mbajtur trajnim dy ditor për stafin e saj. Trajnimi kishte për qëllim ngritjen e vetëdijes për parandalimin dhe menaxhimin e rreziqeve për shkeljen e integritetit.
- ✓ ABGJ ka mbështetur Zyrtarët/et për Barazi Gjinore në nivel lokal në realizimin e një trajnimi me temën "Promovimi i Barazisë Gjinore përmes Teknologjisë Informative të Avancuar". Në këtë trajnim morën pjesë 19 Zyrtarë për Barazi Gjinore (ZBGJ) dhe një pjesë e stafit të ABGJ-së. Qëllimi i trajnimit ishte forcimi i kapaciteteve të pjesëmarrësve në përdorimin e teknologjisë së avancuar digjitale, ndikimin e teknologjisë dhe sigurisë kibernetike në aspektin gjinor, si dhe rëndësinë e përdorimit të inteligjencës artificiale për hartimin e politikave gjinore. Trajnimi u mbështet me asistencë teknike nga UN Women Kosovo.
- ✓ Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të Zyrtarëve për Barazi Gjinore për "Ndërmjetësimi si Mekanizëm Alternativ për Zgjidhjen e Kontesteve", ABGJ në bashkëpunim me Oden e Ndërmjetësuesve të Kosovës me mbështetje nga Programi i USAID-it Drejtësia Komerciale ka organizuar një punëtori.
- ✓ Në përmblyllje të fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit dhe në shënim të Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat të Njeriut, me ftesë të Zyrtarëve për Barazi Gjinore në Komunën e Istogut është mbajtur takim me zyrtar nga komuna e Istogut, ku ishin prezent edhe përfaqësues të Agjencisë për Barazi Gjinore, ky nga ana e ABGJ u prezantua korniza ligjore në Republikën e Kosovës që garanton dhe promovon barazinë gjinore, parandalimin e dhunës në familje dhe dhunën në baza gjinore etj.
- ✓ Në kuadër të fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit, Agjencia për Barazi Gjinore ka mbajtur trajnim me Shërbimin Korrektues të Kosovës, me temën "Njohja me bazat e barazisë gjinore dhe legjislacioni në fuqi". Ky trajnim ka për qëllim të rrisë ndërgjegjësimin dhe njohuritë e stafit të Shërbimit Korrektues mbi konceptet bazë të barazisë gjinore, si dhe të promovojë respektimin e legjislacionit të lidhur me të drejtat e barabarta në vendin e punës dhe në shoqëri.

VII. Ndërmarrja e aktiviteteve vetëdijësuese Janë realizuar tri fushata vetdijësuese dy konferencë dhe pesë videospote:

Konferencat & fushatat vetëdijësuese

- ✓ **ABGJ ka shënuar 8 Marsin Dita Ndërkombëtare e Gruas** nën sloganin **“Bashkë për barazi”** në këtë ditë ne bëjmë thirrje për unitet në mbrojtje të të drejtave të grave dhe vajzave çdokënd. Në linjë me temën globale “Investimi në gra përshpejton progresin”, në këtë konferencë u diskutua për qasjet që nevojiten në mënyrë që të rritet ndikimi dhe të forcohet roli i grave në proceset dhe agjendat e zhvillimit socio ekonomik te vendit, për një transformim shoqëror te qëndrueshëm dhe te barabartë. Konferencën e ndoqën rreth 75 pjesëmarrës.
- ✓ **ABGJ në bashkëpunim me Qendrën Kosovare për Studime Gjinore** ka mbajtur takimin e rregullt konsultativ, të shtatin me radhë, të nivelit të lartë me akterë institucionalë, ekspertë/e dhe përfaqësues/e nga shoqëria civile. Takimi u mbajt në prag të 30-të vjetorit të Platformës së Pekinit, 24 vjetorit të Rezolutës 1325 Gratë Paqja dhe Siguria.ne këtë takim morën pjesën 86 pjesëmarrës.
- ✓ **Tetori muaji kundër kancerit te gjirit:** ABGJ me 14 Tetor 2024 është ndriçuar ndërtesën e Qeverisë me ngjyrë dhe kordelen rozë, simbol i luftës kundër kancerit te gjirit dhe rritjen e ndërgjegjësimit për kontrolle parandaluese.
- ✓ **ABGJ- shënimi i Fushatës Ndërkombëtare për Eliminimin e dhunës ndaj gruas dhe dhunës ne baza gjinore- 16 ditët e aktivizmit.** ABGJ ka ndriçuar Ndërtesat e Qeverise me simbolin e fushatës. Janë shtypur materialeve promovuese –senzibilizuese për fushatën kombëtare (ombrellat, totbeg, kordelet e bardha, fletore) ne kuadër të shënimit të 16 Ditëve të Aktivizmit.
- ✓ ABGJ ne bashkëpunim me ZQM- realizimi i 1500 fletushkave për parandalimin e martesave te hershme.
- ✓ **Videospote promovuese** ABGJ ne zbatim të Ligjit për Barazi Gjinore ka realizuar dhe transmetuar ne RTK dhe ne 3 televisionet private 5 videospote për promovimin e fushave përkatëse-sfera specifike qe afektojnë barazinë gjinore në RKS.

1. Dita Ndërkombëtare e gruas" Bashke për barazi" Buxheti"
<https://www.youtube.com/watch?v=NOo9PSMOCr8&t=8s>
2. “Parandalimi i Ngacmimeve Seksual në Rrjetet Sociale”
<https://www.youtube.com/watch?v=SvHRn4GoY2k>
3. “Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor”:
<https://www.youtube.com/watch?v=nquVSiU2Q-A>
4. “Roli i Mekanizmave Koordinues Lokale për Mbrojtjen nga Dhuna ne Familje”:
<https://www.youtube.com/watch?v=XQ6qz-zrrtg>
5. Parandalimi i gjuhës se urrejtës ndaj grave ne jetën politike dhe publike
<https://www.youtube.com/watch?v=oifzNhu3bzw>

VIII. Komentet e ofruara bazuar ne Ligjin për Barazi Gjinore për integrimin gjinor dhe vlerësimin e ndikimit gjinor. Bazuar në kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore për integrim gjinorë dhe vlerësimin e ndikimit gjinorë ABGJ ka ofruar komente për 1 ligj, 6 projekt ligje, 1 Draft - Program kombëtare dhe 1 strategji, 13 Projekt rregullore, 2 Koncept dokumente, 5 Projekt Udhëzime Administrative.